



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1459/2018

Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. 14106118

Data/Datum/Date: 14/06/18



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

përkitazi me vizitën në Qendrën për Azilkërkues

Për:

Z. Bejtush Gashi, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Valon Krasniqi, Drejtor
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion
MPB

Z. Fitim Zariqi, Drejtor
Qendra për Azilkërkues, Magure

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Qendrën për Azilkërkues.

Prishtinë, më 14 qershor 2018

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

- Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejmë “MKPT”) i Avokatit të Popullit, më 12 mars 2018, ka vizituar Qendrën për Azilkërkues në fshatin Magurë, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejmë “Qendra”). Grupi monitorues përbëhej nga zëvendësja e Avokatit të Popullit, një jurist dhe një mjeke.

Qendra për Azilkërkues

- Qendra për Azilkërkues në Magurë u inaugurua në vitin 2012 dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Me Rregulloren (MPB) nr. 02/2014 për Funksionimin e Qendrës për Azilkërkues (në tekstin e mëtejmë “Rregullorja”), rregullohet çështja e funksionimit dhe menaxhimit të Qendrës, përfshirë procedurën e pranimit, regjistrimit dhe lëvizjes së azilkërkuesve, brenda dhe jashtë Qendrës.¹ Kjo Rregullore, po ashtu rregullon edhe kushtet sanitare, higjenike, ushqimin, ndihmën mjekësore, mirëmbajtjen e rendit dhe disiplinës, si dhe çështje tjera të rëndësishme, lidhur më punën e saj.²

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

- Gjatë vizitës, personeli i Qendrës i ofroi MKPT bashkëpunim të plotë, kështu që ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit i u siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe mundësia për të intervistuar azilkërkuesit, pa prezencë të zyrtarëve të Qendrës.

Keqtrajtimi

- Gjatë vizitës së realizuar, MKPT ka evidentuar se në këtë Qendër ishin akomoduar 21 azilkërkues, ndërsa 11 te tjerë ishin vendosur në banim privat ne Lipjan. Azilkërkuesit kryesisht ishin nga Irani, Libia, Palestina dhe Afganistani. MKPT ka biseduar me disa nga azil kërkuesit, të cilët ishin akomoduar në këtë Qendër. **MKPT nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtimin në këtë Qendër.**

Të drejtat e Azilkërkuesve sipas Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil

- Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil, ka përcaktuar të drejtat e azilkërkuesve, të cilat janë: të qëndrojë në Republikën e Kosovës, të ketë kushtet themelore të jetesës, kujdesin shëndetësor, ndihmën sociale themelore, ndihmën ligjore pa pagesë, të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë, të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar, të drejtën për punësim dhe të drejtën në trajnime profesionale.
- Gjatë vizitës së realizuar më 12 mars 2018 në Qendrën për Azilkërkues, MKPT ka pranuar ankesë nga një familje, e cila ishte e akomoduar në këtë Qendër. Ankesa e tyre kishte të bëjë me ndihmën sociale, e cila sipas pohimeve të tyre, nuk po realizohet me rregull dhe kursi i gjuhës shqipe nuk po mbahej që nga momenti qe janë vendos në këtë qendër.

¹ Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues, nen 1.

² Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues, nen 1 paragrafi 2.

7. MKPT vëren se nen i 41 i Ligjit nr. 06/L-026 përcakton shprehimisht se me qëllim të integrimit në shoqëri: “*personave me status refugjati dhe personave me status të mbrojtjes plotësuese do t’iu mundësohet mësimi i historisë, gjuhës dhe kulturës në Republikën e Kosovës*”.
8. MKPT vëren se nen i 28 i Ligjit nr. 06/L-026 për Azil, shprehimisht përcakton: “*Aplikuesit kanë të drejtë në strehim, ushqim dhe veshmbathje të ofruara në formë mallrash ose në formën e ndihmës financiare ose kuponëve, ose një kombinim i të triave, si dhe një ndihmë financiare për shpenzime të përditshme*”. Më tej, nen i 37 përcakton: “*Personi me status refugjati dhe personi me status te mbrojtjes plotësuese ka të drejtë në ndihmë të domosdoshme sociale nën kushte të njëjta me shtetasit e Republikës së Kosovës*”.
9. Më datë 25 prill 2018, lidhur me ankesat e azilkërkuesve të cekura më lartë, MKPT kontaktoi udhëheqësin e Qendrës për Azilkërkues, nga i cili u njoftua se ndihma sociale u është dhëne, duke i kompensuar edhe muajt paraprak, ndërsa, kursi i gjuhës shqipe ka filluar të mbahet qe nga data 27 mars 2018.

Garancitë kundër keqtrajtimit

10. Neni 5 i Rregullores shprehimisht përcakton: “*Zyrtarëve të Qendrës iu ndalohet të diskriminojnë dhe të fyejnë dinjitetin e azilkërkuesve, për shkak të racës, besimit fetar, gjinisë, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror ose bindjeve politike*”. Po ashtu nen i 5 paragrafi 2 i Rregullores përcakton se: “*asnjë azilkërkues nuk do t’i nënshtrohet torturës, trajtimit jo njerëzor dhe përulës*”. Neni 6.3 i Rregullores përcakton obligimin e zyrtarit të Qendrës që azilkërkuesin ta njoftoj për të drejtat dhe obligimet e tij, si dhe procedurën e azilit, duke përfshirë mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike pa pagesë dhe mundësinë e kontaktimit me përfaqësuesit e UNHCR-së, ose organizatat tjera, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve, në gjuhën e tij ose në një gjuhën të cilën ai e kuption.
11. MKPT u njoftua se, azilkërkuesit njoftohen për të drejtat e tyre në gjuhë të ndryshme, përmes afisheve dhe broshurave. Po ashtu, në dispozicion të Qendrës është edhe lista e përkthyesve të MPB. Ndihma juridike falas, e në raste të shumta edhe përkthimi, u ofrohet nga organizata jo-qeveritare CRPK (Civil Rights Program Kosovo). **MKPT nuk ka pranuar asnjë ankesë nga ankuesit lidhur me mos respektimin e të drejtave të lartpërmendura.**
12. Po ashtu, MKPT ka vërejtur se në të gjitha korridoret e Qendrës operojnë kamerat e sigurisë, gjë që janë një garanci shtesë kundër keqtrajtimit.³

Kushtet materiale

13. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues, MKPT ka vizituare hapësirat, në të cilat ishin akomoduar azilkërkuesit, siç janë: dhomat e intervistimit, dhomat e fjetjes, dhomat familjare, si dhe dhomat e aktiviteteve për të rritur dhe fëmijë, të cilat ishin të pajisura me TV, biblioteka, e cila kishte një numër të vogël të librave, dhomën e aktiviteteve për fëmijë, të pajisur me lodra, dhomën ku mundësohej kryerja e riteve fetare, kuzhinën, e

³ Shih standaret e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës dhe raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2010.

cila ishte e kompletuar me orendi, si dhe një lavanteri, të pajisur mjaftueshëm për kapacitetin e Qendrës.

14. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të denjë, ngrohje, pastërti dhe ndriçim të mjaftueshëm natyral. Qendra ofronte banja të përshtatshme dhe ujë të ngrohtë pa ndërprerë, ku azilkërkuesit e akomoduar mund të pastrohen sa herë që dëshirojnë. Po ashtu, në oborrin e Qendrës, ishte edhe këndi i lojërave për fëmijë. Në përgjithësi, MKPT konsideron se Qendra i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të azilkërkuesve.

Ushqimi

15. Ligji për Azil dhe Rregullorja përcaktojnë të drejtën e azilkërkuesit për ushqim. MKPT u njoftua, se azilkërkuesve në Qendër u ofrohen tri shujta me ushqim gjatë ditës, ndërsa azilkërkuesve që vuajnë nga ndonjë sëmundje, siç është diabeti, u sigurohet ushqim, bazuar në raportin mjekësor. MKPT ka vërejtur, se Qendra posedon kuzhinën me të gjitha pajisjet përcjellëse, e cila ishte në gjendje të mirë dhe e pastër.
16. MKPT ka pranuar ankesa nga azilkërkuesit se ushqimi që iu ofrohet, për nga cilësia është i dobët dhe po shërbehet i ftohtë. Po ashtu janë pranuar ankesa sa i përket orarit të servimit të darkës.
17. Sipas drejtorisë, ky problem do të zgjidhet ashtu që kuzhinieri i qendrës do t'ua shërbejë ushqimin azil kërkuesve dhe jo kompania e cila e furnizon qendrën me ushqim.

Kujdesi shëndetësor

18. MKPT u njoftua se shërbimet mjekësore të huajve në këtë qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare.
19. Neni 9 i Rregullores (Ekzaminimi mjekësor) shprehimisht përcakton se, personeli profesional mjekësor kryen ekzaminimin e përgjithshëm mjekësorë të të huajve, pas vendosjes së tyre në këtë qendër. Rregullorja më tej parasheh se të gjithë të huajve të moshës mbi pesë vjeçare duhet tu bëhet testi i tuberkulozes dhe në kuadër të kësaj duhet tu bëhet rëntgeni i mushkërive.
20. Më tej, sipas Rregullores, azilkërkuesit më aftësi të kufizuara mendore ose fizike, kanë të drejtë për trajtim dhe këshillim profesional mjekësor. MKPT, më 12 mars 2018, nga drejtori i qendrës u njoftua se, Qendra posedon hapësira për ofrim të shërbimeve mjekësore dhe se do të angazhojë personelin e duhur mjekësor, kështu që, Qendra do të ketë shërbimin e vet mjekësor.
21. MKPT, u njoftua se azilkërkuesit në momentin e akomodimit i bëhet një rëntgen i mushkërive, analizat laboratorike dhe një kontroll i përgjithshme mjekësore. Shpenzimet për barna i mbulon MPB. MKPT ka vërejtur se të gjitha të dhënata lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj azilkërkuesit mbahen në dosjen e tij/saj personale.

Fëmijët

22. Gjatë vizitës në Qendër, MKPT u njoftua se një familje azilkërkuese, e cila ishte akomoduar në këtë Qendër, kishte një fëmijë të moshës 11 vjeçare.

23. Neni 13 i Rregullores përcakton, se interesi më i mirë i fëmijëve duhet të merret në konsideratë, gjatë zbatimit të Rregullores. Sipas Rregullores, fëmijëve të cilët kanë qenë viktimi e çfarëdo forme të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, torturës ose trajtimit çnjerëzorë dhe johuman ose që kanë vuajtur nga konfliktet e armatosura do t'iu afrohen shërbime adekuate të trajtimit shëndetësorë dhe këshillime të kualifikuara, kur është e nevojshme. Po ashtu, Fëmijëve të akomoduar në Qendër do t'iu sigurohet qasje në aktivitete zbavitëse dhe lojëra në pajtim me moshën e tyre. MKPT, ka vërejtur se në Qendër ekziston këndi i lojërave për fëmijë brenda në ndërtësë, si dhe në oborrin e Qendrës.
24. Gjatë vizitës, MKPT u njoftu se, për momentin, në Qendër nuk ka fëmijë të pashoqëruar, si dhe viktima të identifikuara të dhunës dhe torturës.

Masat disiplinore

25. Neni 45 i Rregullores përcakton masat disiplinore, të cilat mund t'i shqiptohen azilkërkuesit, nëse nuk i zbaton udhëzimet e përcaktuara në këtë Rregullore, të cilat janë: refuzimi i lejes për dalje nga objekti, kufizimi i qasjes në TV apo internet. Në rast se ndonjë nga azilkërkuesit e vendosur në Qendër, manifeston dhunë apo sjellje agresive, me çka rrezikon rendin dhe sigurinë në Qendër, i njëjtë mund të vendoset në dhomat e veçanta të Qendrës dhe menjëherë rasti referohet te organet kompetente (Policia).

Procedurat e pranimit

26. Neni 6 i Rregullores përcakton se, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), në kuadër të MPB vendos, në bazë të dokumenteve përkatëse, nëse një individ duhet të strehohet në Qendër ose në ndonjë vend tjeter. Qendra konfirmon me anë të fletëpranimit strehimin e azilkërkuesit i cili i bashkëngjitet dosjes së azilkërkuesit. Më pastaj, azil kërkuesi njihet me të drejtat dhe obligimet, bëhet kontrolli i tij/saj dhe ekzaminimi mjekësor.

Procedura e parashtrimit të ankesave

27. Çështja e parashtrimit të ankesave është e rregulluar me nenin 19 të Rregullores, i cili ka përcaktuar se azilkërkuesi ka të drejtë t'i parashtrojë ankesë udhëheqësit lidhur me kushtet e pranimit dhe trajtimit nga zyrtarët e Qendrës. Anesa më pas përcillet tek Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), në kuadër të MPB-së, në afat prej 7 ditësh.
28. MKPT ka vërejtur se në dispozicion të azilkërkuesve në Qendër është një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra.


Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrisë së Punëve të Brendshme:

- **Të përshtatet orari i ushqimit sipas nevojave të azil kërkuesve, sidomos koha kur shërbehet darka.**
- **Të njoftohet MKPT e Avokatit të Popullit për gjendjen sa i përket dhënia së ndihmës sociale në pajtim me Ligjin për Azil.**

- Të njoftohet MKPT e Avokatit të Popullit për mbarëvajtjen e kursit të gjuhës shqipe dhe aspekteve tjera të integrimit në shoqëri në Republikën e Kosovës.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshire edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.



Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokati i Popullit